3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;
- Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (4 x 5)
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Cilësia e kërkuar për materialet e vendosura për mirëmbajtjen.

Në specifikimet teknike të ashensorëve është e domosdoshme të respektohen instruksionet e mirëmbajtjes duke ndjekur protokollin e parashikuar. Inxhinieri i zbatimit të mirëmbajtjes **duhet të vendosë për pjesë ndërrimi dhe materiale të certifikuar dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i ashensorëve ose ekuivalent.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i mirëmbajtjes së ashensorëve përfshin mirëmbajtjen prapake sipas grafikut mujor të shërbimeve teknike (minimum dy here në muaj) të urdhëruar nga Autoriteti kontraktor, si dhe riparimet me zëvendësim pjesë ndërrimi. Është detyrë e kontraktorit të mirëmbajtjes, zgjedhja e pajisjeve mbështetëse të tilla që mundësojnë realizimin e procesit të mirëmbajtjes dhe përzgjedhjes së "skuadrës së mirëmbajtjes" të aftë për të kuptuar dhe realizuar proceset e mirëmbajtjes të parashikuara në këtë raport.

Ofertuesit duhet të kenë një paketë të plotë të dokumentacionit të funksionimit dhe mirëmbajtjes që konsiston në dokumentat e mëposhtëm:

Informacioni Teknik.

- a) Procedurat rutinë
- b) Procedurat speciale

c) Defektet më të shpeshta

Manuali i mirëmbajtjes duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Në “Grafikët e shërbimeve mirëmbajtëse” dhe “Urdhërat e riparimit” duhet të jepen të dhënat e mëposhtme:

- a) Të dhëna të përgjithshme,
- b) Grafikun e ndërhyrjeve të mundshme,
- c) Riparimet e nevojshme,
- d) Garancinë,
- e) Të dhëna mbi instalimin, funksionimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen,
- f) Veprimet mbrojtëse të mirëmbajtjes (kujdesin ndaj goditjeve elektrike),
- g) Përshkrimin e veprimeve ndërhyrëse,
- h) Historikun e ndërhyrjeve mirëmbajtëse.

TË GJITHA MATERIALET DHE PJSËT E NDËRRIMIT QË DO TË PËRDOREN PËR RIPARIME ME ZËVËNDËSIM PJSËSH DO TË JENË MATERIALE TË CERTIFIKUARA DHE ORIGJINALE TË PRODHUARA NGA PRODHUESI I PAJISJEVE OSE EKVIVALENT QË PËRMBUSHIN STANDADET CE.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia
1	Kabina e ashensorit: Gjëndja e dyshemesë . Mbyllja mekanike + elektrike e dyerve. Ndriçimi i kabinës. Butonat dhe llampat e prenotimit. Butonat hapje+mbyllje porte Ventilatori+gjëndja në tërësi	orë pune	550
2	Tavani i kabinës: Gjëndja e tavanit të kabinës.Kontroll, pastrim, rregjistikim operatori Kontakti i parashutës. Vajisje e shinave të kabina+k/peshave. Gominat e fiksimit kabinë-arkade. Kontroll tokëzimi kavo, kabinë arkade. Gjëndjen e fijeve flesibël.	orë pune	490
3	Salla e makinerive: Pastrimi dhe ndriçimi i sallës. Provë rregullatorit, valvolës së rënies Kontroll gjëndjes kavos së rregullatorit Kontroll funksionimit të automatëve Provë dispozitivit . Gjëndja në tërësi emergjencës	orë pune	426
4	Arganello e ashensorit: Kontroll i nivelin e vajit në reduktor Kontroll i ventilatorit ftohës .Pastrimi i elektromotor, reduktor . Kontroll për xhoko vidë-koronë, pastrimi i temburos së kontroll pulexhos el/motorit+devijimet, fortësisë së sustës së frenit. Kontroll gjëndjen e ferrotave të frenit.	orë pune	395
5	Kafazi i ashensorit: Pastrimi, shtrëngimi i stafave të shinave. Pastrimi, shtrëngimi i dyerve të katit Kontroll i stafave të petashuqeve. Ndriçimi i kafazit. Tokëzimi i shinave	orë pune	365

6	<p>Kuadri i manovrës: Kontroll zhurme lëshues, rele etj. Shtrëngim fije tek lëshuesit dhe relet . Provë + rregjistrim termikun e thithjes Kontroll tokëzimit të kuadrit. Kontroll përqafimi i morsetave tek skeda. Pastrim skede, kontroll transformatori.</p>	orë pune	274
7	<p>Arkaden: Kontroll dado tirante, morsetat e kavove .Kontroll morsetat e kavos së rregullatorit. Shtrëngimi i bulonave të arkaden Kontroll xhoko (hapsire) guarnicioneve Gjëndja e tirantit, prova e parachutës. Kontroll arkades, k/peshës dhe kovot, vaisje shinave, kabinë+kundrapesha Gjëndja fizike në tërësi</p>	orë pune	334
8	<p>Gropa e ashensorit: Kontroll, pastrim i gropës. Kontroll i deviatorit dhe prizës. Kontroll i gjëndjes së sustës+zinxhirit. Kontroll distc. kabinë-k/peshë-susta. Kontroll kontakti kavos së rregullatorit. Kontroll gjëndjes pulexhos tendikavos. Kontroll i zgjatjes së kavos rregullatorit. Kontroll bazamentit, korodimit shinave</p>	orë pune	243
9	<p>Portat e kateve: Kontroll i mbylljes mekanike dyerve Kontakti elektrik, çelësi i emergjencës, pastrim i kasës sipër dhe i karelit Kontroll-rregjistrim i hapsirës ulave. Kontroll për konsumim, shtrëngim i patinave rulat e akopjimit. Provë Kontroll i zhurmës së derës në hapje butonave + llampat e kateve</p>	orë pune	220
10	<p>Të përgjithshme: Gjithnjë bëhet kontroll i funksionimit të impiantit, alarmit, llampës së emergjencës dhe manovrën me dorë</p>	orë pune	182
11	<p>Në çdo tre muaj bëhen këto verifikime dhe kontrole: Funksionimin e alarmit pa tension, Konsumin, zgjatjen, rrëshqitjen e kavove. Tokëzimin e ashensorit. Limitatorin e shpejtësisë. Kontroll i qarqeve të sigurisë dhe mbrojtjeS. Distanca kat-kabinë (max 30 mm). Valvolën e rënies, Efikasitetin e termikut</p>	orë pune	274
12	F.v. vajnica dhe vaj makinerie	copë	28
13	F.v. graso në nyjet lëvizëse	copë	17
14	F.v. llampa per ndriçimin e pusit	kg	18
15	F.v. çelsa te dyreve te kateve	copë	16

16	F.v. çelsa avarie te kabines	copë	16
17	F.v. butona te thirrjes se kateve	copë	20
18	F.v. rripa transmisioni të dyerve	copë	20
19	F.v. llampa kabine per ndriçim	copë	16
20	F.v. sensorë manjetik	copë	20
21	F.v. automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A	copë	4
22	F.v. automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A	copë	4
23	F.v. butona tregues te dyreve te jashtme	copë	16
24	F.v kabëll fleksibël ashensori	m	80
25	F.v kavo çeliku fi 11-13 mm	m	240
26	F.v. patina portash	copë	16
27	F.v. rula për hapje dhe mbyllje dere	copë	31
28	F.v. ferrota për frenat e motorrit	copë	16
29	F.v. operator kabine	copë	4

Afatet e ekzekutimit:

Bazuar në marrëveshjen Kuadër që do të lidhet me OE të sukseshëm, Autoriteti kontraktor do të lidhë (mini)kontrata sipas nevojave për të arritur të funksionojnë normalisht të gjithë ashensorët nëpërmjet kryerjes së shërbimeve teknike të programuara dhe riparimeve të nevojshme. Do të kërkohet realizimi i të gjithë shërbimeve të parashikuara si dhe riparimet e nevojshme në sasi dhe llojshmëri.

Sasia e riparimeve me zëvendësim pjesë ndërrimi (F.v.) është sasi e pritshme.

Afatet e ekzekutimit:

Kontratat e lidhura bazuar në Marrëveshjen Kuadër do të zbatohen si vijon:

1. Për shërbimet teknike mirëmbajtëse, me njësi matëse "Orë pune", hartohet Grafik shërbimesh të programuara nga grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratave. OE merr një kopje dhe e zbaton në sasi, cilësi dhe afatin e urdhëruar.

2. Për riparime me njësi matëse "F.v. (furnizim vendosje)", me lindjen e nevojave, Grupi i punës lëshon "Urdhër riparimi" ku jepet sasia, çmimi njësi sipas kontratës lidhur në bazë të MK dhe afati i ekzekutimit (realizimit).

Grafiku i ekzekutimit të shërbimeve mirëmbajtëse

Do t'i bëhet me dije operatorit ekonomik kontraktues në momentin e lidhjes së minikontratave në zbatim të marrëveshjes kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti i Shërbimit mirëmbajtës: Sigurimi i gatishmërisë teknike dhe funksionimit normal të ashensorëve duke krijuar kushte optimale pune në objektet arsimore. Hartimi i manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes.

Qëllimi i shërbimit mirëmbajtës: Mundësimi i një kontrate për **riparim-mirëmbajtje** të ashensorëve në objekte arsimore në juridiksionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Të gjitha materialet e tjera që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuar konform standartit (CE). Në përgjithësi materialet e kërkuara janë të specifikuar edhe në listën e çmimeve apo formularin e shërbimeve, dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi.

Detyrat:

Kontrata zbatohet me grafik riparim-shërbimesh të programuara mujore dhe urdhëra riparimi të lëshuara nga AK sipas nevojave. Operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës do të mbajë kontakt të përditshëm me përfaqësues të AK të ngarkuar për ndjekjen e planit (procedurës) të zbatimit të kontratës, plan të cilin OE dhe AK e nënshkruajnë brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Nr.	Objekti arsimor	Vendodhja	Tipi i ashensorit	Numër ndalesa	Peshë ngritja (kg)	Funksioni	Orë pune në ditë
A	Shërbime riparim-mirëmbajtëse						
1	Shkolla Kosova	Rr. Elbasanit / Nj.B.Nr.2	Hidraulik	5	630	7 persona	16
2	Shkolla Kongresi i Manastirit	Rr. 3 Deshmoret / Nj.B.Nr.6	Hidraulik	3	450	6 persona	14
3	Shkolla Betim Muço	Rr. Llazi Miho/ Nj.B.Nr.6	Elektrik me motorr me shinë	3	535	6 persona	16
4	Shkolla Lasgush Poradeci	Rr. Petraç Leka/ Nj.B.Nr.6	Elektrik me motorr me shinë	4	540	6 persona	14
5	Shkolla Servete Maçi	Rr. Dibrës/Nj.B.Nr.9	Hidraulik	3	630	7 persona	16
6	Shkolla Hasan Vogli	Rr. Haxhi Dalliu/Nj.B.Nr.9	Hidraulik	3	450	5 persona	14
7	Shkolla Sami Frashëri	Rruga e Barikadave /Nj.B.Nr.9	Hidraulik	4	540	6 persona	14

8	Çerdhja Nr.52	Rr. "Ali Visha" / Nj.B.Nr.2	Elektrik për kuzhinën	2	150	mallra	8
9	Çerdhja Nr.42	Rr. "Aleksander Moisiu" / Nj.B.Nr.4	Elektrik për kuzhinën	2	150	mallra	8
10	Kopshti Nr.42	Rr. "Nikolla Tupe" / Nj.B.Nr.5	Elektrik për kuzhinën	2	150	mallra	8
B	Shërbime mirëmbajtëse						
1	Shkolla Nënë Tereza	Rr. "Pajsi Vodica" / Nj.B.Nr.11	Hidraulik	5	600	6 persona	12
2	Shkolla Vaçe Zela	Rr. "Eshref Frashëri" / Nj.B.Nr.9	Hidraulik	3	600	6 persona	12
3	Shkolla Kristo Frashëri	Rr. "Eshref Frashëri" / Nj.B.Nr.9	Hidraulik	3	600	6 persona	12
4	Shkolla Bashkim Fino	Rr. "Jorgjia Truja" / Nj.B.Nr.2	Hidraulik	4	540	6 persona	12
5	Shkolla Andrea Stefani	Rr. "Gjergj Legisi" / Nj.B.Nr.11	Hidraulik	4	600	7 persona	12
6	Shkolla Asim Vokshi	Rr. Elbasanit / Nj.B.Nr.2	Hidraulik	4	540	5 persona	12
7	Shkolla Xhezmi Delli	Rr. Xhezmi Delli/ Nj.B.Nr.3	Hidraulik	3	540	6 persona	12
8	Shkolla Besnik Sykja	Rr. Bajram Curri / Nj.B.Nr.5	Hidraulik	4	600	6 persona	12
9	Kopshti Nr.41	Rr. "Budi" / Nj.B.Nr.2	Elektrik për kuzhinën	2	150	mallra	8
10	Kopshti Nr.68	Rr. "Jorgjia Truja" / Nj.B.Nr.2	Elektrik për kuzhinën	2	150	mallra	8
11	Kopshti Nr.69	Rr. "Artan Lenja" / Nj.B.Nr.7	Elektrik për kuzhinën	2	150	mallra	8

Shpërndarja: Nga momenti i lidhjes së marrëveshjes kuadër me afat ekzekutimi 24 (njëzet e katër) muaj.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: vendodhja e kryerjes së shërbimeve do të jetë në objektet arsimore të përshkruara në Shtojcën 7 sipas kushteve të përcaktuara në DST.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente shtetërore, sipas formatit të miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik ofertues lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- * NS - 3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, **b)** Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Drejtuesin Teknik të shërbimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024 dhe në vazhdim, dhe të jetë i deklaruar në licencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar në funksion të realizimit të objektit të prokurimit të paktën 4 (katër) punonjës, për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024 dhe në vazhdim.

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ❖ Listëpagesat e sigurimeve shoqërore të lëshuara nga organet kompetente shtetërore, për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.
- ❖ Vërtetim nga organet kompetente shtetërore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata/dëshmi kualifikimi profesional të lëshuara nga institucione të akredituara/liçensuara sipas ligjit ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 1 (një) punonjës inxhinier mekanik
- ❖ 2 (dy) punonjës teknikë ashensori të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
- ❖ 1 (një) punonjës specialist auditues për kontrollin e cilësisë së shërbimeve.

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë/dëshmi kualifikimi profesional).

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 2 (dy) punonjës të cilët të jenë pajisur me çertifikatën e trajnimit "Për punimet në lartësi dhe përdorimin e Pajisjeve të Mbrojtjes Personale për mbrojtjen e rënies nga lartësia" ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr.312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier" dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024 dhe në vazhdim. Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/ liçensuara.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Automjet ATP	1 copë	Pronësi ose me qira
2	Komplet vegla pune elektrike/mekanike dhe për matje tokëzimi	1 copë	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qirasë dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.....

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
